



Komuna Klinë

Kuvendi i Komunës

01Nr. 052-860 2025

Klinë, me datë: 09.01, 2025

PËR: DREJTORINË E ADMINISTRATËS – DREJTORIN, Z. BINAK SYLA
NGA: SHËRBIMI PËR PUNË TË KUVENDIT – AHMET BARISHA

Barisha



**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT DHE I ZYRËS PËR PUNË TË
KUVENDIT PËR VITIN 2024**

1. RAPORTI I ZYRES PER PUNË TE KUVENDIT

Shërbimi për pune të Kuvendit për funksionalizimin e tij mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Udhëzime Administrative dhe Rregullore të ndryshme nga Qeveria e RKS, Statutin e Komunës së Klinës, si dhe rregulloreve të tjera të komunale. Varësisht prej natyrës së propozim vendimeve dhe draft- rregulloreve, planeve, raporteve, strategjive etj. që parashtrohen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend në bashkëpunim edhe me Zyrën Ligjore, Drejtorit Komunale-Ekzekutivin.

Ky shërbim punën e vet e mbështet edhe në Planin vetor të punës së Kuvendit dhe komiteteve të Kuvendit.

Shërbimi kryen përgatitjet profesionale dhe teknike për mbajtjen e seancave të rregullta të Kuvendit të Komunës, ku parashihet të mbahen 11 seanca të rregullta të punës brenda vitit kalendarik sipas planit të punës së Kuvendit.

Zyra për pune të kuvendit, përgatit mbajtjen e seancave të jashtëzakonshme dhe urgjente si dhe të atyre solemne të Kuvendit të Komunës.

Po ashtu shërbimi organizon mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve të Kuvendit: dy komitetet obligative të cilat mbajnë nga 11 mbledhje brenda vitit. Komitetet konsultative së paku 6 mbledhje, komitetet tjera që janë 5, mbajnë mbledhje sipas nevojës.

Debatet me publikun mbahen sa here që paraqitën për debat : Projekt-rregullore, plane apo strategji të ndryshme.

-Ky shërbim gjatë vitit kalendarik 2024 ka përgatitur punën për mbajtjen e gjithsejtë **11-Seanca të rregullta të Kuvendit.**

Janë bërë përgatitjet për 11 seanca të rregullta të Kuvendit, duke bërë koordinimin për hartimin e pikave të rendit të ditës, përgatitjes së materialeve në bashkëpunim me drejtorinë komunale dhe zyrën ligjore.

-Është bërë hartimi i Propozim - vendimeve, të cilat kanë ardhur nga Zyra e Kryetarit, së bashku me dokumentacion janë bartur për shqyrtim dhe miratim në seance të Kuvendit por paraprakisht janë shqyrtuar në Komitetin për Politike dhe Financa dhe debate me publikun. që janë mbajtur 2, përgatitjen e procesverbaleve dhe bartjen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, ky shërbim, rendin e ditës e pranon nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit me propozimet e tyre, të drejtorive komunale, anëtareve të kuvendit, komiteteve, gjithashtu edhe kërkesa të tjera të interesit të përgjithshëm.

Me caktimin e pikave te rendit të ditës duhet te pasojnë edhe kërkesat draft -vendimet me dokumentacion përkatës nga vete drejtoritë komunale, te bazuara ne ligjet në fuqi, ne konsultim me Zyrën ligjore, Drejtorinë e Financave dhe Zyrën për Integritet Evropiane, në mënyre që vendimi te mos kthehet për rishqyrtim në Kuvend nga ministrit e linjës.

2. Raporti i punës se Kuvendit-2024

-Ky shërbim gjatë vitit kalendarik 2024 ka përgatitur punën për mbajtjen e gjithsejte 11 seanca të rregullta dhe 2 seanca solemne.

Gjatë 11- seancave të Kuvendit janë përgatitur dhe miratuar **55 Vendime** ku nga këto vendime të miratuar vetëm **6 vendime janë kthyer për rishqyrtim** ku me këtë rast janë rishqyrtuar me kohë ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Janë miratuar **gjithsejtë 7 Plane**, janë shqyrtuar 4 raporte për menaxhimin financiar te komunës 1 për vitin 2023 dhe 3 raporte të vitit 2024. Gjithashtu Kryetari ka raportuar 2 herë për gjendjen ekonomike-financiare sipas nenit 58 të LVL-se, është miratuar KAB-2025-2027 si dhe Buxheti me projektet e Komunës për vitin **2025**.

-Kuvendi ka miratuar rregullore:

-Rregullore për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës.

-Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Klinës.

Janë shqyrtuar Raportet: Raporti vjetor i Punës së Ekzekutivit, Kuvendit-komiteteve te Kuvendit, dhe Prokurimit si dhe Raporti i Auditorit të jashtëm dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit.

Janë mbajtur **2** debate me publikun lidhur me konsultimet rreth, KAB 2025-2027,dhe Draft-Buxhetit te Komunës për vitin 2025.

-Njoftimet për mbajtjen e seancave te KK, janë bërë për te gjithë anëtarët e Kuvendit, MAPL, Ekzekutivin, OJQ, OSBE, KFORI, Policia e RKS-njësia ne Kline, radio "Alba" dhe janë transmetuar drejtpërdrejt nga portali "Klina Info"

- Njoftimi është bere publik ne ueb faqen e komunës, ne forme te shkruar në objektin e komunës, dhe në radion lokale.

Gatë seancës së Kuvendit, Komitetit për Politike dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, mbahen procesverbalet, te cilat publikohen ne ueb faqe zyrtare te komunës.

- Gjithashtu aktet tjera te miratuara janë protokolluar ne afatin prej 7 ditësh dhe i janë dërguar Ministrisë se Administrimit te Pushtetit Lokal për konfirmim te ligjshmërisë, Arkivit te Komunës dhe Kryetarit.

Pas konfirmimit te ligjshmërisë i janë dërguar Zyrës për Informim për publikim ne ueb faqen e komunës ku aktet behën te plotfuqishme.

- Jane shqyrtuar te gjitha kerkesat.

- Jane mbajtur kontakte rreth puneve dhe pergjegjiesive qe i kemi si sherbim me MAPL,

Asociacionin e komunave te Kosovës, me Kryetarin e Komunës, me Kryesuesin dhe drejtorin e Administratës.

Janë dhen raporte për çdo tremujor për MAPL.

3. Komitetet obligative:

Ky Shërbim ka përgatitur punën për mbajtjen e dy Komiteteve obligative:

- Komitetit për Politike dhe Financa (KPF) dhe
- Komitetin për Komunitete (KPK).

Komiteti për Politike dhe Financa

Ky komitet ka mbajtur gjithsej 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta.

Ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, Draft-rregullore, draft-plane, draft-strategji

Janë bërë të gjitha përgatitjet duke u mbështetur në pikat e rendit të ditës të propozuara nga kryesuesi i kuvendit, kryetari dhe drejtoritë komunale apo kërkesa të ndryshme duke respektuar edhe LVL, Statutin e komunës, UA si dhe Rregulloret komunale dhe Planin e punës së Kuvendit dhe komiteteve.

Përgatitjet janë bërë me caktimin e rendit të ditës, kompletimin dhe shumëzimin e materialit, sigurimin e lektorimit dhe përkthimit sipas mundësive të përkthyesit.

Tani materiali për Kuvendin dhe Komitetin për Politike dhe Financa dërgohet vetëm në formë elektronike. Janë mbajtur procesverbalet gatë mbajtjes së mbledhjes dhe të njëjtit janë protokolluar dhe janë dërguar për publikim në ueb faqe dhe ruhen në këtë shërbim.

Janë përgatitur rekomandimet lidhur me pikat e rendit të ditës të cilat janë shqyrtuar dhe bartur për Kuvend.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 11 seanca të rregullta

4. Komitetet Konsultative:

Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk ka mbajtur asnjë takim
Komiteti për Çështje Emergjente ka mbajtur 1 takim.

5. Komitetet Tjera

- Komiteti për Arsim, Kulturë, Rinë dhe Sport- 0 takim
- Komiteti për Shëndetësi dhe Miregenie Sociale- 0 takim
- Komiteti për Shërbime Publike- 1
- Komiteti për Pronë- 0
- Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim- 0

6. Këshilli për Siguri në Bashkësi, gjithsej ka mbajtur 6 takime të rregullta të parapara sipas planit të punës së KKSB-së

7. Debate me Publikun janë mbajtur- 2 nga Kuvendi